



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr 609/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimiq dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur për shkak të parregullsive të në QV nr 0606c, në vendvotimin 01R në fshatin Vrellë Komuna e Istogut, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

### VENDIM

**HIDHET** posht si e palejuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

### ARSYETIMI

Më datën 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LDK e cila thekson se me datën 12.12.2010 pas mbylljes së kutive të votimit dhe numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultateve për subjektet politike veç e veç në fletën e punës të FRP-ës janë shënuar numrat e votave për subjektet politike në përputhje me numrin e bere të fletëvotimeve. Gjate bartjes së këtyre të dhënave në origjinalin e FRP-ës ka ndodhur një gabim teknik, kështu që të gjitha votat ,përkatësisht 197 vota, të subjektit politik me numër rendor 36 (LDK) janë shënuar si vota të subjektit politik me numër rendor 35 (PAI). Në këtë vendvotim sipas parashtruesit të ankesës PAI nuk ka pasur asnjë votë. Ky gabim është vërejtur pas përpunimit të rezultateve të votave preliminare nga komisioni komunal i zgjedhjeve. Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës emrat dhe nënshkrimet e anëtarëve të komisionit të QV 0606C/01R .

Neni 105 paragrafi 1 i LZP-ës specifikon:

*Neni 105.1 Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e palejuar**

PZAP-i vlerëson se ankesa e LDK-se paraqitur ndaj parregullsive të ndodhura në QV nr 0606c, në vendvotimin 01R në fshatin Vrellë është e palejuar pasi që ankesa është bërë para shpalljes së rezultateve preliminare nga KQZ-ja.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 609/2010 më datën 16.12.2010

**Kryesuesi i Panelit**

**Ferit Osmani**

